



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**BASHKIA FUSHË-ARRËZ**  
**KËSHILLI BASHKIAK**

**Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit  
dhe të Drejtave të Njeriut**

Nr. 509 prot.

Fushë-Arrëz, më 26. 02. 2025



**PËR : KËSHILLIN E BASHKISË  
FUSHË-ARRËZ**

**Lënda:** Relacion mbi projektvendimin “Për miratimin e listës së përfituesve të Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Janar 2025”, që do t’i paraqitet Këshillit të Bashkisë për shqyrtim në mbledhjen e tij të datës 28.02.2025.

Ne zbatim të ligjit 139/2015 “Per vetëqerisjen vendore”, i ndryshuar, Rregullores për Funksonimin e Këshillit të Bashkisë, Komisioni i Përhershëm i Mirëqenies Sociale Barazisë Gjinore Mosdiskriminimit dhe të Drejtave të Njeriut në mbledhjen e datës 26.02.2025 me pjesëmarrjen e anëtareve: Franc Doda, Pavlin Qafa dhe Tereze Dema, mori në shqyrtim projektvendimin për miratimin e listës së përfituesve të ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar i bllok-ndihmës ekonomike prej 6% për muajin Janar 2025, paraqitur nga Sektori i Shërbimit Social.

Anëtarët e Komisionit janë njohur me projektin përmes materialit shkresor, nderkohe në mbledhjen e komisionit, shpjegimet i dha Pergjegjesja e Sektorit të Çështjeve Sociale, Sidorela Katroshi, e cila shpjegoi se për muajin Janar 2025 përfitojnë ndihme ekonomike nga fondi i bllok-ndihmës ekonomike prej 6%, 32 familje me fond 125,275 lekë nga fondi total i ndihmës ekonomike në vlerën 2,087,933 lekë dhe shpërndarë për përfituesit e 6% në Shumën 120,390 lekë sipas Njësive:

1. Bashkia Qendër Fushë-Arrëz , 17 familje me fond 61,487 lekë.
2. Njësia Qafë-Mali ,4 familje me fond 13,999 lekë .
3. Njësia Blerim , 4 familje me fond 18,016 lekë.
4. Njësia Fierzë , 2 familje me fond 6,752 lekë .
5. Njësia Iballë , 5 familje me fond 20,136 lekë .

Pavlin Qafa, anëtar i komisionit, shprehet se është dakord me propozimet e bera për familjet përfituese të ndihmes ekonomike nga fondi i bllok ndihmes prej 6 % , le të përfitojnë të gjitha familjet që plotësojnë kriteret e paracaktuara me VKB.

Franc Doda, anëtar i komisionit shprehet se nuk jam dakord që Liljana Doda të jetë në listën e përfituesve sepse nuk plotëson kriteret.

Drejtoresha e Emigracionit e Çështjeve Sociale zj.Sidorela Katroshi, shprehet se Liljana Mark Doda, pikerisht se nuk ka plotësuar kriteret nuk është përfshirë në listat e familjeve përfituese të ndihmes ekonomike prej 6 % për muajin Janar 2025.

Ajo shpjegon gjithashtu se shtohet në bllok-ndihmën e 6% familja: Rexhep Beqir Hasanaj (familje e varfër pa asnjë të ardhur ) nderkohe largohen nga bllok-ndihma prej 6% familjet: Geg Mati Bibaj (Qafë – Mali) është punësuar bashkëshortja; Gjelo Pal Marku ( Lagjia Memaj ) – për riaplikim në Ndihmë Ekonomike.

Franc Doda anëtar i komisionit, thotë se duhet të kontrollohen individët atje ku jetojnë dhe si i kanë kushtet në mënyrë që të trajtohen ato familje që janë në nevojë dhe që plotësojnë kriteret e përfitimit.

Tereze Dema, anetare e komisionit shprehet se është dakord me propozimet e bera për familjet përfituese të ndihmes ekonomike nga fondi i bllok ndihmes prej 6 %. Duhet të ndihmohen edhe familje të tjera në nevojë për aplikim dhe të përfitojnë sipas kriterëve të miratuar nga këshilli bashkiak.

Anëtarët e komisionit kërkojnë domosdoshmërisht zbatimin e kriterëve të përfitimit të 6%.


Pas diskutimit anëtarët e komisionit, me shumicë votash, ranë dakort me projektin e paraqitur dhe kërkojnë miratimin e tij nga Këshilli në mbledhjen e datës 28.02.2025 duke kërkuar edhe mendime dhe propozime të tjera të këshilltarëve të pranishëm.

Duke kërkuar bashkëpunimin tuaj!

**Franc Doda**



**Pavlin Qafa**



**Tereze Dema**

